



# ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2025

Programet e Partive Politike dhe  
Agjenda e Gjelbër

SHKURT, 2025

# **Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2025: Programet e Partive Politike dhe Agjenda e Gjelbër**

Shkurt, 2025

Autor: INDEP

Programi: Zhvillim I Qëndrueshëm

Publikuar: Shkurt, 2025



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

#### **Institute for Development Polic– INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale..



**Rockefeller  
Brothers Fund**  
Philanthropy for an Interdependent World

Programi i INDEP financohet nga Fondi i Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve në këtë punim nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

---

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
Metodologjia.....	4
<b>Agjenda e Gjelbër dhe programet e partive politike .....</b>	<b>5</b>
<b>Dekarbonizimi .....</b>	<b>6</b>
<b>Energjia.....</b>	<b>8</b>
<b>Ekonomia qarkore .....</b>	<b>9</b>
<b>Ndotja e Ajrit, Ujit dhe Tokës.....</b>	<b>10</b>
<b>Biodiversiteti dhe Mbrojtja e Ekosistemeve .....</b>	<b>10</b>
<b>Bujqësi e Qëndrueshme.....</b>	<b>12</b>
Përfundime.....	13

# Hyrje

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 vijnë në një moment kyç për të ardhmen politike dhe ekonomike të Kosovës, veçanërisht në sektorët e energjetikës, mjedisit dhe politikave klimatike. Çështjet e sigurisë energjetike, tranzicioni drejt burimeve të ripërtëritshme dhe përmbushja e objektivave të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor janë sfida të rëndësishme që do të ndikojnë në rrugën e Kosovës drejt integritit evropian dhe në përfitimin e fondeve të BE-së për zhvillim të qëndrueshëm.

Si në zgjedhjet e kaluara, edhe këtë vit, partitë politike do të përballen me nevojën për të ofruar strategji konkrete dhe të zbatueshme për një tranzicion të drejtë energjetik. Kosova vazhdon të mbetet një nga vendet më të varura nga qymyri për prodhimin e energjisë, duke e vendosur atë në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare për dekarbonizim dhe me standardet që kërkon BE-ja për integrim. Në të njëjtën kohë, nevoja për rritjen e efikasitetit energjetik, investimet në energjinë e pastër dhe zgjidhjet inovative për stabilitetin e furnizimit mbeten tema kyçe që kërkojnë zgjidhje.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është ndikimi i politikave ndërkombëtare, përfshirë Marrëveshjen e Parisit dhe Deklaratën e Sofjes për Ballkanin Perëndimor, të cilat kanë krijuar presion për vendet e rajonit që të angazhohen në eliminimin e karbonit deri në vitin 2050. Këto angazhime, të mbështetura nga fondet e BE-së për tranzicionin e gjelbër, përbëjnë një mundësi për Kosovën, por edhe një sfidë për qeverinë e ardhshme për të miratuar politika dhe masa që përputhen me këtë vizion.

Ky dokument analizon qasjet dhe propozimet e partive politike për energjinë, mjedisin dhe klimën në prag të zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025, duke krahasuar masat e propozuara me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e Kosovës ndaj Agjendës së Gjelbër. Duke analizuar platformat politike, dokumenti synon të vlerësojë pajtueshmërinë e politikave energjetike me objektivat e BE-së, si dhe të identifikojë hapësirat për përmirësim dhe rekomandimet për politikëbërësit e ardhshëm.

INDEP tashmë në mënyrë të rregullt e bënë analizimin e programit të partive politike në lensin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm. Nga analiza e programeve tek ofrimi i platformave të gjelbra, INDEP në mënyrë aktive ka synuar vazhdimisht të përcjell mesazhin e shoqërisë civile në debatin elektoral në vend. Kësaj radhe, analiza jonë publikohet vetëm pak ditë para zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025. Kjo pasi, jo të gjithë subjektet politike i bënë publike programet e tyre me kohë. Vetëm pasi kompletuam programet e subjekteve më të mëdha politike ne ishim në gjendje të kryenim analizën krahasuese dhe të nxjerrim gjetjet.

Përfundimisht, analiza synon të ofrojë një udhëzues për qytetarët, politikëbërësit dhe komunitetin ndërkombëtar, duke vendosur tranzicionin energjetik dhe mbrojtjen e mjedisit në qendër të diskutimit për të ardhmen e qëndrueshme të Kosovës. Gjithashtu, duam që duke e ofruar këtë dokument në këtë fazë, ai të jetë edhe bazë e krahasimit me programin qeverisës dhe dokumentet strategjike që partia, apo koalicioni qeverisës do të paraqes nesër në Qeveri. Kështu, monitorimi, transparenca dhe llogaridhënja rritet, në një kohë kur përpjekjet për realizim të Agjendës së Gjelbër shpresojmë të jenë të vazhdueshme dhe lineare me të gjithë periudhën qeverisëse në vend.

## Metodologjia

Ky hulumtim dhe analiza janë realizuar duke përdorur një metodologji të kombinuar kualitative dhe kuantitative. Në pjesën e parë të punës, kemi ndërtuar modelin analitik duke u bazuar në "Udhëzuesin për Implementimin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor" të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, për pjesët që ndërlidhen me energjinë, ndryshimet klimatike dhe qëndrueshmërinë, kemi përdorur indikatorët më të fundit nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe Korniza e Energjisë së Pastër të BE-së për 2030.

Pasi ndërtuam modelin analitik, të dhënat u mbledhën dhe u kuantifikuan me metodën kuantitative, duke analizuar shkallën e përputhshmërisë së programeve të partive me standardet e Agjendës së Gjellbër. Më pas, rezultatet iu nënshtruan analizës kualitative, për të vlerësuar cilësinë, realizueshmërinë dhe ndikimin e masave të propozuara. Fillimisht, analiza u mendua të jetë krahasuese, por kjo qasje kishte kufizimet e saj, pasi partitë politike vazhdojnë të përgatisin programet në formate të ndryshme. Disa subjekte përqendrohen më shumë në identifikimin e problemeve, ndërsa të tjera theksojnë masat konkrete, shpesh pa detaje mbi zbatimin, kostot dhe burimet e financimit.

Për të vlerësuar nivelin e përafrimit të programeve të partive politike me parimet e Agjendës së Gjellbër, kemi zhvilluar një metodologji vlerësimi bazuar në shkallë prej 5 pikësh (0 deri në 4).

### Shkalla e Vlerësimit për Përafrimin me Agjendën e Gjellbër



Figura 1. Shkalla e krahasimit

Çdo pikë pasqyron shkallën në të cilën treguesit specifikë trajtohen dhe elaborohen në programet e partive. Zero (0) tregon se indikatorit është ose plotësisht i munguar ose trajtohet në një mënyrë që bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet e Agjendës së Gjellbër. Një pikë (1) i atribuohet rasteve kur treguesi përmendet shkurtimisht, pa detaje apo elaborim domethënës. Dy pikë (2) nënkupton që treguesi është përshkruar me më shumë se 30 fjalë dhe adreson të paktën njërin nga pyetjet e mëposhtme të zbatimit: si, kur ose në çfarë mase. Tre pikë (3) paraqet një elaborim më të gjerë, duke përfshirë detaje specifike të zbatimit, institucionet përgjegjëse, si dhe të dhëna indikative për kostot dhe afatet kohore. Katër (4) pikë janë dhënë kur ka përputhje të plotë me Agjendën e Gjellbër, e karakterizuar nga përshkrime të detajuara të metodave të zbatimit, afatet kohore, kostot dhe rolet e institucioneve përgjegjëse. Kjo shkallë e strukturuar na mundëson një vlerësim objektiv të përafrimit të programeve me parimet e Agjendës së Gjellbër.

Pasi kemi identifikuar dhe kuantifikuar masat, kemi zhvilluar një analizë që kombinon grafikisht gjetjet kryesore me vlerësimin cilësor të propozimeve. Përmes analizës së përmbajtjes, kemi shqyrtuar programet duke i ndarë gjetjet sipas temave (si energjia, biodiversiteti, transporti, mbrojtja e mjedisit, ekonomia qarkore, etj.), në vend që të fokusoheshim vetëm në partitë politike. Një aspekt i rëndësishëm që mbetet për t'u vëzhguar në të ardhmen është se sa nga këto premtime do të reflektohen në programin qeverisës dhe në implementimin e politikave publike pas formimit

të Qeverisë së re. Për këtë analizë, kemi shqyrtuar programet me shkrim të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Koalicionit për Familje.

## Agjenda e Gjelbër dhe programet e partive politike

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është një strategji e Bashkimit Evropian që synon të udhëheqë tranzicionin e rajonit drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe neutral ndaj klimës. Dokumenti i hartuar nga Komisioni Evropian përfshin pesë shtylla kryesore: (1) dekarbonizimin, (2) ekonominë qarkore, (3) ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, (4) sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe (5) mbrojtjen dhe restaurimin e biodiversitetit.<sup>1</sup> Këto shtylla janë të lidhura ngushtë me objektivat e Marrëveshjes së Parisit dhe me përpjekjet e BE-së për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050.

Kosova përballet me sfida të mëdha mjedisore që e bëjnë zbatimin e Agjendës së Gjelbër një domosdoshmëri, jo vetëm një opsion politik. Sipas dokumentit të BE-së, Ballkani Perëndimor është një nga rajonet më të prekura nga ndryshimet klimatike. Rritja e temperaturave prej 1.7–4.0°C deri në fund të shekullit,<sup>2</sup> valët e të nxehtit, thatësitat e shpeshta dhe ndotja e ajrit përbëjnë rreziqe serioze për shëndetin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Për më tepër, varësia nga qymyri për prodhimin e energjisë (mbi 90%) e bën Kosovën një nga ndotësit më të mëdhenj të karbonit në Evropë.

Në këtë kontekst, Agjenda e Gjelbër ofron mekanizma financimi dhe asistencë teknike për vendet që angazhohen seriozisht në tranzicionin energjetik dhe në ruajtjen e mjedisit. Nëse Kosova nuk i ndjek këto standarde, ajo rrezikon të mbetet mbrapa në procesin e integritimit evropian dhe të përballet me taksat e karbonit nga BE-ja për eksportet e saj në tregun evropian.

Më 10 nëntor 2020, vendet e Ballkanit Perëndimor treguan përkushtimin e tyre ndaj zhvillimit të qëndrueshëm duke nënshkruar Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Ky angazhim i rëndësishëm përfshin adoptimin e Agjendës së Gjelbër si një "hartë" për zbatimin e veprimeve dhe masave konkrete, me qëllim arritjen e zhvillimit me karbon të ulët dhe nxitjen e rritjes ekonomike, duke respektuar parimet e qëndrueshmërisë.<sup>3</sup> Është zbatim i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjes Evropiane të Gjelbër dhe një kusht për Kosovën në rrugën e integritimit.


Megjithëse Agjenda e Gjelbër duhet të jetë prioritet për çdo parti që synon zhvillim të qëndrueshëm, programet politike në Kosovë tregojnë nivel të ndryshëm të përkushtimit ndaj kësaj agjende. Disa parti kanë plane të qarta për tranzicionin energjetik dhe ekonominë qarkore, ndërsa të tjera vazhdojnë të mbështesin përdorimin e qymyrit dhe projekte që nuk përputhen me synimet e BE-së. Në fakt, grafiku në vazhdim paraqet një nivel tejet të vogël të përafrimit bazuar në kriteret e përcaktuara në Agjendën e Gjelbër.

---

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, (2020), Guidelines for the Implementation of the Green Agenda for the Western Balkans, i qasshëm në [green agenda for the western balkans en.pdf](#) (qasur janar, 2025)

<sup>2</sup> Ibid, faqe 2.

<sup>3</sup> Balkan Fund, (2022), Balkans United for Clean Air, i qasshëm në [Green Agenda ENG.pdf](#) (qasur në janar, 2025)



*Figura 2. Totali i përafritimit krahasuar me maksimumin*


Në kapitujt e mëtejshëm do të shqyrtojmë detajisht qasjen e secilës parti ndaj pesë shtyllave të Agjendës së Gjelbër veç e veç.

### **Dekarbonizimi**

Dekarbonizimi, procesi i reduktimit të emetimeve të karbonit për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050, është një nga shtyllat kryesore të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Ai përfshin kalimin nga lëndët djegëse fosile në burime të ripërtëritshme si dielli, era dhe hidroenergji, përmirësimin e eficiencës energjetike, dhe ndërtimin e sistemeve të transportit të qëndrueshëm.

Kosova është një nga ndotësit më të mëdhenj në Evropë për shkak të varësisë së saj mbi 90% nga qymyri për prodhimin e energjisë. Termocentralet e saj të vjetruara, "Kosova A" dhe "Kosova B", lëshojnë nivelin më të lartë të grimcave ndotëse në rajon, duke ndikuar në ndotjen e ajrit dhe problemet shëndetësore të popullatës. Për më tepër, BE-ja po zbaton mekanizmin e taksës së karbonit (CBAM), i cili do të penalizojë vendet që nuk zbatojnë masa për uljen e emetimeve. Kjo e bën dekarbonizimin një urgjencë ekonomike dhe mjedisore për Kosovën.





*Figura 3. Përafritimi sipas partive të dekarbonizimit*

Në kontekstin e dekarbonizimit, partitë politike në Kosovë tregojnë qasje të ndryshme, ku disa përpiqen të adresojnë tranzicionin energjetik, ndërsa të tjerat mbeten të lidhura me qymyrin. AAK fokusohet në sigurinë energjetike, por nuk ka një strategji të qartë për dekarbonizimin. Synimi për ndërtimin e një termocentrali të ri 500MW dhe mungesa e planeve për zëvendësimin e qymyrit me burime të ripërtëritshme e bën programin e saj të papajtueshëm me Agjendën e Gjelbër. Ndonëse propozon zhvillimin e rrjetit të gazit, kjo mbetet vetëm një masë kalimtare, pa garanci për një tranzicion të plotë drejt energjisë së pastër.

LDK ka strategjinë më të qartë për tranzicionin energjetik. Parashikon mbylljen e Kosova A, ndërtimin e një termocentrali me gaz (500MW), rehabilitimin e Kosova B dhe investimin në energjinë diellore dhe të erës (1000MW gjithsej). Synon një reduktim të varësisë nga qymyri, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe integrimin rajonal, duke e bërë atë më të përafuar me Agjendën e Gjelbër.

PDK është e vetmja që përmend drejtpërdrejt dekarbonizimin, duke propozuar investime në energjinë e ripërtëritshme dhe masa për efikasitetin energjetik. Megjithatë, plani për një termocentral me gaz (350MW) dhe hidrocentrale të rinj mund të ketë ndikime mjedisore. PDK propozon gjithashtu Agjencinë One-Stop-Shop për lehtësimin e investimeve në energji të pastër, por i mungon një plan konkret për mbylljen e termocentraleve me qymyr.

LVV nuk ka asnjë strategji për dekarbonizim. Pavarësisht premtimeve për më shumë energji nga burimet e ripërtëritshme, nuk ka masa për mbylljen e termocentraleve me qymyr. Është përmendur rehabilitimi i Kosovës A, pa specifikuar cilët njësi dhe për çfarë periudhe.

Koalicioni për Familje është më së largëti nga objektivat e dekarbonizimit, duke propozuar ndërtimin e një termocentrali të ri me qymyr (1200MW). Ky projekt e largon Kosovën nga integrimi evropian dhe sjell sfida për financime ndërkombëtare, duke e bërë atë tërësisht të papajtueshëm me Agjendën e Gjelbër.

## Energjia

Kosova përballet me sfida të mëdha në sektorin e energjisë, për shkak të varësisë së lartë nga qymyri (mbi 90%), mungesës së investimeve në burime të ripërtëritshme, dhe problemeve me infrastrukturën e shpërndarjes dhe integrimin në tregjet rajonale të energjisë. Termocentralet Kosova A dhe Kosova B, të cilat sigurojnë pjesën më të madhe të energjisë elektrike të vendit, janë ndër më ndotësit në Evropë dhe kërkojnë modernizim ose zëvendësim për të përmbushur standardet mjedisore të BE-së.

Po ashtu, kemi humbje të mëdha energjetike, sidomos në ndërtesat publike dhe private, ku mungon izolimi i mirë termik, si dhe në rrjetin e shpërndarjes, ku humbjet teknike dhe jo-teknike arrijnë në nivele të larta. Mungesa e politikave të qarta për kursimin e energjisë dhe përdorimin e teknologjive eficiente bën që konsumatorët të paguajnë më shumë dhe rrjeti të mbetet i mbingarkuar. Investimet në eficiencën energjetike mund të ndihmojnë në uljen e kërkesës për energji, përmirësimin e sigurisë së furnizimit dhe reduktimin e kostove për qytetarët dhe bizneset. Në përputhje me Agjendën e Gjellbër, Kosova duhet të zbatojë politika dhe subvencione për të inkurajuar eficiencën energjetike

AAK propozon reduktimin e TVSH-së në energjinë elektrike në 6% për të lehtësuar barrën financiare të qytetarëve dhe për të rritur përballueshmërinë e konsumit. Ajo synon një reformë të thellë në KEK, duke e bërë atë të qëndrueshëm financiarisht dhe teknikisht, si dhe integrimin në rrjetet energjetike rajonale dhe evropiane për të forcuar bashkëpunimin me Shqipërinë dhe për të mundësuar eksportin e energjisë. Masa për eficiencën e energjisë përmendin vetëm reduktimin e humbjeve teknike, pa ndonjë incentivë për konsumatorët.

AAK dhe Koalicioni për Familje janë subjektet e vetme që me shkrim kanë propozuar ndërtimin e një termocentrali të ri me qymyr.

LDK propozon masa për eficiencën e energjisë, përfshirë izolimin e ndërtesave dhe investime në rrjetet e zgjuara. Një aspekt inovativ i programit është përdorimi i fondeve pensionale për investime në energjinë e pastër. Gjithashtu, promovon bashkëpunimin me Shqipërinë për të shfrytëzuar energjinë hidro, duke krijuar një miks më të ekuilibruar. Megjithatë, mbështetja në gaz si lëndë kalimtare mbetet e debatueshme. LDK ka propozuar investime prej 70 milionë euro në izolimin e ndërtesave publike dhe private, zëvendësimin e pajisjeve joeficiente dhe ngritjen e ndërgjegjësimit për kursimin e energjisë.

PDK fokusohet në sigurinë e furnizimit me energji dhe zhvillimin e infrastrukturës energjetike. Një nga projektet kryesore të saj është ndërtimi i një termocentrali me gaz 350 MW, si dhe ndërlidhja me tubacione me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. PDK propozon gjithashtu investime në hidrocentrale të reja dhe studime për ndërtimin e ujëmbledhësve, me synimin për të rritur prodhimin nga burimet vendore. Masa për eficiencën e energjisë, si izolimi i ndërtesave dhe subvencionet për teknologji të gjelbërta, janë të dobishme, por kërkojnë më shumë detaje. Megjithatë, programi i saj nuk përfshin një strategji të qartë për eficiencën energjetike apo për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme.

Programi i LVV-së për energjinë është i përgjithshëm dhe pa detaje konkrete mbi investimet dhe furnizimin. Programi për eficiencë energjetike me vlerë 150 milionë euro për izolimin e ndërtesave është pozitiv, por mungesa e një plani të qartë për energjinë e pastër e bën LVV partinë më pak të përputhshme me Agjendën e Gjellbër. Koalicioni për Familje e konsideron energjinë një nga sfidat kryesore për zhvillimin ekonomik, duke përmendur problemet me furnizimin e paqëndrueshëm dhe nevojën për investime të reja. Një nga propozimet më të rëndësishme është ndërtimi i një termocentrali të ri me thëngjill, Kosova e Re, me kapacitet 1200 MWh, që do të kushtojë 2.4

miliardë euro. Financimi do të vijë përmes buxhetit të shtetit, bonove të thesarit dhe investimeve të Trustit.

Programi I Koalicionit përmend ngrohoret qendrore dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme, por nuk jep detaje mbi efikasitetin energjetik apo burimet e ripërtëritshme, nuk përmend masat për kursimin e energjisë në sektorin publik dhe privat, apo për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes.

## Ekonomia qarkore

Ekonomia qarkore është një model i prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm, i cili synon reduktimin e mbetjeve, riciklimin, ripërdorimin dhe zvogëlimin e përdorimit të burimeve natyrore. Në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, BE-ja inkurajon vendet e rajonit të zhvillojnë infrastrukturë për menaxhimin e mbetjeve, strategji për riciklimin dhe të integrojnë prodhimin industrial me standardet e BE-së.




Figura 4. Përafrimi sipas partive të Ekonomisë Qarkore

Kosova përballlet me probleme të theksuara në menaxhimin e mbetjeve, mungesën e infrastrukturës për riciklim dhe dëmtimin e burimeve natyrore për shkak të praktikave jo të qëndrueshme ekonomike. Shumica e mbetjeve menaxhohen në mënyrë të paorganizuar, me shumë deponi ilegale, ndërsa kapacitetet për riciklim janë minimale.

Programet e partive politike për ekonominë qarkore ndryshojnë ndjeshëm, me disa që ofrojnë strategji të detajuara dhe të tjera që nuk trajtojnë këtë çështje. LDK fokusohet në zhvillimin industrial dhe përafrimin me standardet e BE-së, duke përmendur eliminimin e barrierave tregtare për produktet e ricikluara dhe promovimin e industrisë së gjellbër, por pa një plan specifik për menaxhimin e mbetjeve. PDK, nga ana tjetër, ka qasjen më të detajuar, duke propozuar ndërtimin e qendrave të klasifikimit dhe trajtimit të mbetjeve, riciklimin e 50% të mbetjeve komunale deri në vitin 2030, eliminimin e deponive ilegale dhe investime në trajtimin e mbetjeve të ndërtimit dhe demolimit, duke bërë atë programin më të avancuar në këtë aspekt. LVV nuk ofron një strategji të qartë për riciklimin, menaxhimin e mbetjeve apo reduktimin e plastikës, duke mos përfshirë politika konkrete për zhvillimin e një ekonomie qarkore. AAK propozon zhvillimin e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare, por nuk jep detaje mbi strategjitë e riciklimin dhe ripërdorimit të materialeve. Koalicioni për Familje përmend

menaxhimin e mbetjeve dhe ndërtimin e një sistemi riciklimi, por nuk shpjegon se si do të zbatohet kjo strategji, duke lënë të paqartë investimet në këtë sektor. Në përgjithësi, PDK ka programin më të plotë për ekonominë qarkore, ndërsa LDK, AAK dhe Koalicioni për Familje kanë qasje të përgjithshme, dhe LVV nuk adreson fare këtë fushë.

## Ndotja e Ajrit, Ujit dhe Tokës

Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës është një nga çështjet më të rëndësishme mjedisore, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve dhe ekosistemet natyrore. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor e BE-së thekson nevojën për uljen e ndotjes nga industria dhe transporti, mbrojtjen e burimeve ujore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave. Partitë politike në Kosovë kanë qasje të ndryshme ndaj kësaj çështjeje, me disa që ofrojnë plane konkrete dhe të tjera që mbeten në qasjet e përgjithshme.




Figura 5. Përafrimi sipas parimeve për ndalim të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës

Programet e partive politike për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës variojnë në qasje dhe përputhshmëri me Agjendën e Gjelbër. AAK ka një plan të detajuar, duke propozuar ndërtimin digave, megjithëse ndërtimi i digave të shumta mund të ndikojë negativisht në ekosisteme, po ashtu AAK propozon ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Gjithashtu, synon eliminimin e plastikës dhe kontrollin e deponive ilegale. LDK propozon një qasje të integruar ligjore, duke përfshirë amendamentin kushtetues për të drejtën e një mjedisi të pastër, si dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura dhe forcimin e standardeve të BE-së. PDK fokusohet në rritjen e kapaciteteve ujore përmes ndërtimit të Kanalit të Lepencit dhe digave, si dhe në eliminimin e mbetjeve nga lumenjtë dhe promovimin e transportit të pastër, por nuk adreson në mënyrë të detajuar riciklimin. LVV ofron vetëm një qasje minimale, duke propozuar ndërtimin e digave pa trajtuar ndotjen e ujërave dhe ajrit. Koalicioni për Familje përfshin masa për ndotjen industriale, promovimin e bujqësisë organike dhe përdorimin e teknologjive të filtrimit të gazrave, por mbetet më pak i detajuar se programet e LDK dhe PDK.

## Biodiversiteti dhe Mbrojtja e Ekosistemeve

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor përfshin ndalimin e degradimit të habitateve natyrore, mbrojtjen e zonave të ndjeshme dhe rritjen e sipërfaqeve të gjelbra. Partitë politike në Kosovë

kanë qasje të ndryshme ndaj kësaj çështjeje, me disa që ofrojnë masa konkrete, ndërsa të tjera që kanë vetëm angazhime të përgjithshme ose nuk trajtojnë fare këtë temë.




Figura 6. Përafrimi me shtyllën e biodiversitetit

Në fushën e biodiversitetit dhe mbrojtjes së ekosistemeve, PDK ka programin më të detajuar, duke ofruar masa konkrete për mbrojtjen e natyrës, pyllëzimin dhe ndërtimin e një Parku Botanik Kombëtar. LDK ka një qasje më të institucionalizuar, duke synuar harmonizimin me BE-në dhe garantimin e mbrojtjes së mjedisit përmes ligjeve dhe standardeve të reja. AAK dhe Koalicioni për Familje kanë një fokus të kufizuar në pyjet dhe parqet kombëtare, ndërsa LVV nuk ka asnjë politikë për këtë sektor. Për përputhshmërinë me Agjendën e Gjelbër, PDK dhe LDK janë më të afërta me objektivat e BE-së, ndërsa AAK, Koalicioni për Familje mbeten prapa në këtë aspekt, dhe LVV nuk e trajton fare fushën e biodiversitetit dhe mbrojtjes së ekosistemeve.

## Bujqësi e Qëndrueshme

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor kërkon një tranzicion drejt një ekonomie të qëndrueshme, duke përfshirë bujqësinë e qëndrueshme, mbrojtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin rural. Programet e partive kosovare pasqyrojnë qasje të ndryshme ndaj këtyre objektivave. LDK dhe PDK janë më të përafuara me Agjendën e Gjelbër, duke propozuar masa për rritjen e efikasitetit në përdorimin e burimeve natyrore, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe mbështetjen e bujqësisë organike. PDK përfshin gjithashtu investime në ripyllëzim dhe standarde mjedisore për eksportet. AAK fokusohet kryesisht në financimin dhe modernizimin e infrastrukturës bujqësore, por pa një komponent të qartë për reduktimin e ndikimit mjedisor. KF përmend inovacionin dhe tregtinë, por nuk ka një plan të mirëfilltë për zhvillimin e qëndrueshëm rural. LVV nuk ka ndonjë propozim konkret në këtë sektor, duke lënë një boshllëk në vizionin e saj për zhvillimin rural dhe ushqimin e qëndrueshëm.

	L.FAMILJA	LVV	PDK	LDK	AAK-NISMA
<b>4.1. Bujqësi e kujdesshme ndaj mjedisit</b>	1	0	2	1	0
<b>4.2. Përmirësimi i informimit të konsumatorëve dhe promovimi i ushqimit të qëndrueshëm</b>	0	0	0	0	0
<b>4.3. Përafrimi i sektorëve agrorë dhe të prodhimit me standardet e BE-së</b>	0	0	2	0	1
<b>4.4. Forcimi i kontrolleve sanitare dhe përmirësimi i etiketimit të ushqimeve</b>	0	0	0	1	0

## Përfundime

Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor nuk është një opsion, por një detyrim për Kosovën nëse synon të përshpejtojë integrimin në Bashkimin Evropian. Si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe kornizës së Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, Kosova duhet të përafrojë politikat e saj mjedisore dhe klimatike me standardet e BE-së, duke përfshirë dekarbonizimin, menaxhimin e ndotjes, ekonominë qarkore dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Programet e partive politike për zgjedhjet e vitit 2025 nuk kanë përfshirë në masë të kënaqshme shtyllat, parimet dhe treguesit e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin perëndimor. Ndonëse një përfshirje deri diku kemi parë tek programet e LDK-së dhe PDK-së me disa propozime të qarta dhe të harmonizuara me Agjendën e Gjellbër, subjekti me përafrimin më të madh prapë nuk shkon më shumë se rreth 20% të treguesve të Agjendës së Gjellbër.

Një veçanti e këtyre zgjedhjeve është fokusi më i madh tek projektet ekzekutive sesa tek vizioni programatik ose platforma. LDK ka adoptuar një qasjen institucionale dhe ligjore, duke e propozuar një ndryshim kushtetues për të garantuar mjedisin e pastër si një të drejtë themelore, ndërsa PDK ka avancuar me plane konkrete për ruajtjen e biodiversitetit, ripyllëzimin dhe promovimin e turizmit ekologjik. AAK dhe Koalicioni për Familje kanë integruar disa elemente të rëndësishme për ruajtjen e burimeve natyrore, por mbeten të paqarta mbi mekanizmat e zbatimit dhe financimit të reformave të tyre. LVV ka dështuar të trajtojë aspekte kyçe të Agjendës së Gjellbër, me pak përjashtim në infrastrukturën ujore, por pa një strategji të qartë për ndotjen, biodiversitetin dhe energjinë e pastër.

Kosova nuk mund të anashkalojë Agjendën e Gjellbër nëse synon të avancojë drejt anëtarësimit në BE. Politikat mjedisore janë një pjesë kyçe e kriterëve të Kopenhagës, dhe përmbushja e tyre është thelbësore për hapjen e kapitujve negociues. Pa masa konkrete dhe zbatim të rreptë, rruga drejt integritit evropian mund të ngadalësohet, duke lënë Kosovën pas vendeve të tjera të rajonit. Prandaj, angazhimi për një ekonomi të gjellbër dhe qëndrueshmëri mjedisore nuk është vetëm një politikë e mirë, por një domosdoshmëri strategjike për të ardhmen e Kosovës. Natyrisht, përveç programeve të shkruara, në retorikën e përditshme partitë politike kanë zgjeruar gamën e ofertës zgjedhore. Sidoqoftë, ishte në metodologjinë e kësaj analize që të shohim vetëm pjesët e shkruara të programeve zgjedhore. Fundja për to, si të shkruara, mund të kërkohet llogaria e vërtetë.

Programi i INDEP financohet nga Fondi i Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve në këtë punim nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

